

20111342961

LIGJ
PËR GARANCI TË REPUBLIKES SË MAQEDONISE NDAJ DETYRIMEVE SIPAS
MARREVESHJES PËR HUA PËR FINANCIM TË PROJEKTIT HC BOSHKOV MOST,
QË DO TË LIDHET NDERMJET BANKES EVROPIANE PËR RINDERTIM DHE
ZHVILLIM DHE SHA ELEM

Neni 1

Republika e Maqedonise e garanton shlyerjen e detyrimeve dhe permbushjen e dispozitave nga Marreveshja për hua e dedikuar për financimin e Projektit HC Boshkov Most, që do të lidhet ndermjet Bankes Evropiane për Rindertim dhe Zhvillim dhe SHA ELEM , në shume prej 65 000 000 eurosh, në afate dhe kushte të parapara në Marreveshje për hua, nese SHA ELEM nuk i permbush dhe servison detyrimet nga Marreveshja për hua.

Neni 2

Kushtet dhe menyra e shfrytezimit të huas nga neni 1 i ketij ligji, percaktohen me Marreveshje për hua, që do të lidhet ndermjet Bankes Evropiane për Rindertim dhe Zhvillim dhe SHA ELEM për financimin e Projektit HC Boshkov Most.

Neni 3

Të gjitha detyrimet që dalin nga Marreveshja për hua nga neni 1 i ketij ligji, si dhe servisimin e huas, do t'i permbushen SHA ELEM nga të hyrat që i realizon, në afate dhe kushte të percaktuara në Marreveshje për hua.

Neni 4

Afati i pageses së huas nga neni 1 i ketij ligji eshte 15 vjet, me grejs periodhe të perfshire prej pese vitesh.

Shkalla kamatare eshte EURIBOR gjashtemujor variabil i rritur për 1% margjine vjetore.

Huaja do të paguhet në 20 keste gjysmevjetore, çdo 15 mars dhe 15 shtator të vitit.

SHA ELEM do t'i paguaje Bankes Evropiane për Rindertim dhe Zhvillim provizion të njehershem në shume prej 1% nga shuma e huas. Për shumen e mjeteve të paterhequra të huas, Bankes Evropiane për Rindertim dhe Zhvillim do t'i paguhet provizion në lartesi prej 0,5% nga shuma e mjeteve të paterhequra të huas në nivel vjetor.

Neni 5

Për rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve të ndersjella që dalin nga Marreveshja për hua dhe Marreveshja për garanci, Ministria e Financave dhe SHA ELEM do të lidhin marreveshje të vecante.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonise".